

**AKTI I THEMELIMIT**  
**TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“ED\_ER Konstruksion” shpk**

Sot, më 17.10.2023, unë, themeluesi,

- a) Markel Lamçe, atësia Gëzim, shtetas shqiptar, identifikuar me anë të pasaportës me numër BC0387940, me numër personal identifikimi I70805090M i datëlindjes 05.08.1987, lindur në Vlorë dhe banues në Vlorë; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas kushteve të mëposhtme.

**Neni 1**  
**Themelimi**

- 1) Emri i shoqërisë është **“ED\_ER Konstruksion” shpk**.
- 2) Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 3) Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**Neni 2:**  
**Objekti**

- 1) Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:
  - a) Projektimi dhe zbatimi, ndertime civile, turistike, bujqesore, ujesjelles kanalizime, rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike, prodhime e tregtim te materialeve te ndertimit, blerje dhe shitje te mjeteve te ndryshme, transport mallrash, shitje me shumice dhe pakice te produkteve bujqesore, bimore. Punime karpenterie, hekuri, murature e suvatime, kalluposje, shtrim me pllaka e nivelime, si dhe nivelime, punime hidraulike dhe elektrike. Sherbime hotelerie, bare-restorante si dhe tregtim me pakice dhe shumice te karburanteve dhe tregtise me shumice e pakice te mallrave te ndryshem etj. Blerje dhe shitje dhe menaxhimin e pasurise se luajtshme dhe paluajtshme te pasurive ne emer te tyre dhe ne emer te paleve te treta. Import, eksport dhe tregeti me pakice dhe shumice te artikujve te ndryshem industriale dhe ushqimore, elektroshtepiake, elektrike, pjese kembimi,

materialeve te ndertimit lende te para, makineri si dhe transporti i tyre brenda dhe jashte vendit. prodhim dhe tregetim te materialeve te ndertimit si dhe betoneve te markave te ndryshme. Import, eksport dhe tregeti me pakice dhe shumice te lendeve djegese.

- b) Blerje paisje kompjuterike, blerje kancelari, blerje mjete pune të ndryshme etj.
- c) Mirëmbajtje në terrenet e jashtme sportive.

### **Neni 3: Kohëzgjatja**

- 1) Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

### **Neni 4: Selia**

- 1) Shoqëria e ka selinë në Rruga Suljeman Delvina, Lagjja Hajro Çakerri, Pallati L.O.R.L, kati 1, Vlorë.
- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

### **Neni 5 Kapitali themeltar**

- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100'000 (njqind mije ) Lekë dhe është i ndarë në 1 (nje) kuote. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:  
Ortaku themelues Markel Lamçe, zotërues i 1 (nje) kuote me vlerë të përgjithshme 100'000 (njqind mije) Lekë, që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë
- 2) Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

### **Neni 6 Administratori**

- 1) Administratori i shoqërisë emërohet Markel Lamçe, atësia Gëzim shtetas shqiptar, identifikuar me anë të pasaportës me numër BC0387940, me numër personal identifikimi I70805090M i datëlindjes 05.08.1987, lindur në Vlorë dhe banues në Vlorë, me afat emërimi 5 vjeçar.

**Neni 7**  
**Baza Ligjore**

- 1) Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 8**  
**Mosmarrëveshjet**

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

**O R T A K U**  
**E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“ED\_ER Konstruksion” shpk**

**Markel Lamçe**

**(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)**